



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 196 Prot.

Tiranë, më 11.5.2017

U R D H Ë R

Nr. 475, datë 11.5.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E SHKELJEVE TË TJERA TË LIGJIT NR. 9049, DATË
10.4.2003 "PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË
DETÝRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE DISA NËPUNËSVE
PUBLIKË", TË NDRYSHUAR EDHE ME LIGJIN NR. 42/2017, DATË 6.4.2017.**

Në zbatim nenit 15 pika 1 gërmë a), nenit 40 pika 1 gërmë dh) të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuara në pikën 1, gërmë dh) të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur:

1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve financiare nga subjektet e përcaktuar në nenin 3 dhe 3/1 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003, i ndryshuar, apo personat e lidhur me ta, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj;
 - a) Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk kanë plotësuar formularin e duhur të deklaratës së interesave privatë, sipas llojit të detyrimit për deklarim ose sipas modelit të formularit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm dhe të botuar në Fletoren Zyrtare.
 - b) Subjekti deklarues apo personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar të gjitha fletët e formularit të deklaratës së interesa privatë, ku janë pasqyruar të dhëna lidhur me objektin e deklarimit.
 - c) Subjekti deklarues nuk ka plotësuar autorizimin dhe nuk ka pasqyruar, në deklarimin e tij të interesave privatë, faktin nëse ka ose jo persona të tjerë të lidhur me të, sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

- c) Personat e lidhur madhorë me subjektin deklarues, që kanë detyrim për deklarim, nuk kanë plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave privatë.
 - d) Subjekti deklarues deklaron të dhënat edhe për personat e lidhur, kur këto të fundit disponojnë pasuri të regjistruar veçmas dhe për pasojë detyrohen ligjërisht të plotësojnë fletët përkatëse të këtij formulari.
 - dh) Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk deklarojnë të ardhurat apo detyrimet financiare sipas kërkesave të formularit të deklaratës së interesave privatë.
 - e) Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk kanë pasqyruar saktë vlerën e aseteve, të të ardhurave apo detyrimeve dhe/ose sipas monedhës përkatëse.
 - ë) Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk kanë deklaruar pasuri për të cilën kanë deklaruar burimin financier apo kanë deklaruar pasuri dhe nuk kanë deklaruar burimin financier që ka shërbyer për krijimin e tyre.
 - f) Subjekti deklarues apo personat e lidhur me të, në deklarimin e interesave privatë, periodike vjetore apo pas largimit nga funksioni, nuk pasqyrojnë, sipas kërkesave ligjore, shtesa/pakësimë apo ndryshime të gjendjes pasurore, por deklarojnë gjendjen e tyre.
2. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk paraqiten brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003, i ndryshuar, për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave privatë.
 3. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk depozitojnë dokumentacionin justifikues për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, gjatë kontrollit dhe/ose hetimit administrativ.

Urdhëri nr. 27 datë 13.3.2014 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Shkëlqim GANAJ

